



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1445/prot.
4

Tiranë më 6.12.2017

VENDIM

Nr. 98, datë 6.12.2017

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi Znj. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1445 Prot., datë 30.10.2017, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”). Ankuesi nëpërmjet kërkesave së datave 25.09.2017, 06.10.2017 dhe 23.10.2017 ka depozituar pranë Autoritetit Publik kërkesën për informacion dhe dokumentacionin si më poshtë:

1. Cilat janë kompanitë për të cilat keni aprovuar dhënie lejesh koncesionare për ndërtim hecesh në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dhe ato nën dy MGW (prej 1 Janarit 2017 e deri tani, pra në datën e kthimit të përgjigjes tuaj)?
2. Sa është numri i lejeve të dhëna për secilën kompani, gjatë periudhës në fjalë?
3. Sa është kapaciteti në KW për secilin hidrocentral?
4. Sa është vlera e investimit që ka ofruar kompania për secilin hidrocentral?
5. Cilat prej këtyre lejeve janë shoqëruar prej VKM-ve përkatëse (leje për të cilat ka VKM dhe për ato leje që e kërkon vetë ligji që të ketë)?
6. Në cilat lumenj (degë dhe bazene) janë dhënë?

Autoriteti Publik nuk i është përgjigjur kërkesit. Me pretendimin se është çenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 1445 Prot., datë 30.10.2017 pranë

Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me shkresën nr. 1445/1 Prot. datë 06.11.2017, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, i ka kërkuar Autoritetit Publik përmbushjen e detyrimit për dhënie informacioni brenda datës 13.11.2017.

Autoriteti Publik nuk ka kthyer përgjigje duke refuzuar dhënien e informacionit. Komisioneri, me urdhrin nr.298 datë 24.11.2017 vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik. Gjatë inspektimit, nga Koordinatorja për të Drejtën e Informimit të Autoritetit Publik u sqarua se: *informacioni i kërkuar nuk është vënë në dispozicion edhe për shkak të ristrukturimit të institucionit dhe riorganizimit të drejtorive përkatëse.*

Komisioneri pas konsultimit të legjisllacionit përkatës vlerëson se, informacioni i kërkuar nga Znj. , përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “*informacion publik*” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik” dhe si i tillë, dhënia e tij nuk mund të refuzohet.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit të sipërcituar: “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

Krahas faktit që informacioni publik duhet të publikohet në mjediset e autoritetit publik, apo kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet, nga monitorimi i faqes zyrtare është konstatuar se informacioni nuk rezultoi i publikuar si parashikohet në ligj dhe nuk është i aksesueshëm.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Për sa më lart, në lidhje me ankimin e Znj. ndaj Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankimi është i bazuar në ligj dhe si i tillë ai duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankimit të Znj. Nr. 1445 Prot., datë 30.10.2017, kundër Autoritetit Publik "Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar:
 - a) Cilat janë kompanitë për të cilat keni aprovuar dhënie lejesh koncesionare për ndërtim hecesh në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dhe ato nën dy MGW (prej 1 Janarit 2017 e deri tani, pra në datën e kthimit të përgjigjes tuaj?
 - b) Sa është numri i lejeve të dhëna për secilën kompani gjatë periudhës në fjalë?
 - c) Sa është kapaciteti në KW për secilin hidrocentral?
 - d) Sa është vlera e investimit që ka ofruar kompania për secilin hidrocentral?
 - e) Cilat prej këtyre lejeve janë shoqëruar prej VKM-ve përkatëse (leje për të cilat ka VKM dhe për ato leje që e kërkon vetë ligji që të ketë?
 - f) Në cilat lumenj (degë dhe bazene) janë dhënë? brenda datës 14.12.2017.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Ky vendim u dha sot në datë 06.12.2017.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

